



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL ELBASAN

Data 02.12.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE MATERIALE PER KIRURGJINE E KATARAKTES PER SPITALIN
RAJONAL ELBASAN**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Materiale
mjekesore te konsumueshme - kodit 33140000-3**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 3,742,350 (tre milion e shtateqind e dyzet e dy mije e treqind e
pesedhjetë) leke pa Tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Elbasan** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERE

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Formularin e ofertës sipas shtojcës 2*

c. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të perlogaritur**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", I ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdotatimpaguespergatitdeklaraten vjetoret e të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20 % të fondit limit të vënë në dispozicion.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror dhe faturat tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara / shërbimeve të kryera.

ose

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është

kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

(Është minimumi i kërkesës për arsye që të vërtetojë që ka kapacitet financiar për ta kryer këtë furnizim dhe shërbimet e lidhura me ato). Rekomandimi i APP-së nr. 1797/1 i datës 10.03.2022

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Kerkohet **Autodeklaratë** për materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori / prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC (sipas aplikimit të vlefshmërisë), ose 98/79/EC (sipas aplikimit të vlefshmërisë) ose 98/34 EC (sipas aplikimit të vlefshmërisë), ose EU Regulation 2017/745, dhe Amendimit të Rregullores (EU) 2023/607, bashkëlidhur me kopjet e çertifikatave përkatëse FDA ose CE/DC (Deklaratë Konformiteti) kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, origjinale ose fotokopje dhe nëse nuk janë në gjuhën angleze ose shqipe, të përkthehen në gjuhën angleze ose shqipe dhe të noterizohen

Argumentimi: Ky kriter i përcaktuar në pikën c) është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kritereve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr.145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë. Autoriteti kontraktor kërkon konformitet me direktivat (si MDD 93/42/eec, MDD 93/42/eec ...;) dhe rregulloret e BE (si Rregullorja 745/2017/EU), për t’u siguruar se materialet / pajisjet mjekësore që do të ofertojnë nga operatori ekonomik i suksesshëm janë prodhuar dhe vendosur

në treg në përputhje me rregullat e cilësisë, të përcaktuara në këto akte. Në këtë mënyrë, gjykojmë se përcaktimet konkrete të akteve ligjore të Bashkimit Evropian nuk përbëjnë pengesë për OE të interesuar, duke marrë parasysh se këta të fundit janë të detyruar të ofertojnë mallra që janë prodhuar / vendosur në treg duke përmbushur standardet më të larta, kjo duke u bazuar edhe në faktin, se kjo praktikë e ndjekur ndër vite nga AK ,veprimtaria e të cilës ka të bëjë drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte me jetën e pacientit, ka rezultuar e suksesshme.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikimin **ISO 9001:2015** mbi **“Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter i percaktuar ne piken b) dhe c) eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

Ky kriter gjen mbeshtetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.

Autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Elbasan kërkon nga ofertuesit përmbushjen e kriterëve të mësipërme për të vërtetuar se artikujt/pajisjet mjekësore objekt prokurimi kanë ndjekur një proces rigoroz prodhimi, duke patur në konsideratë konsumatorin fundor, efektivitetin e artikullit/materialit mjekësor, si dhe aftësinë për të prodhuar, ruajtur dhe ofrimin e asistencës për përdorimin e këtyre pajisjeve.

ISO 9001:2015- Eshte nje standart nderkombetar qe percakton kerkesat per nje sistem menaxhimi te cilesise. Ky eshte nje standart shume i njohur dhe perdoret gjeresisht ne industrine e prodhimit dhe te sherbimeve.Nje akreditim i tille eshte shume i rendesishem sepse garanton besueshmeri dhe legjitimitet dhe siguron qe procesi i certifikimit eshte kryer ne perputhje me standartet europiane. Rendesia e certifikimit me **ISO 9001:2015** qendron ne garantimin e nje

standarti te larte dhe nje sistemi menaxhimi te orjentuar drejt cilesise dhe besueshmerise. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.3.3

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **autorizim nga firma prodhuese / MAH / distributori i autorizuar**, (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) **per tregtimin e mallrave objekt prokurimi**. Autorizimi duhet të jetë origjinal dhe nëse nuk është në gjuhën angleze ose shqipe, të përkthehet në gjuhën angleze ose shqipe dhe të noterizohet.

Argumentimi: Ky kriter gjen mbeshtetje ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: 5. *Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor I autorizuar prej prodhuesit është një document i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues .

Autorizimi i prodhuesit eshte i vetmi dokument i cili mund t’i deshmoje autoritetit kontraktor lidhjen e ofertuesit me nje distributor te autorizuar apo drejtperdrejt me prodhuesin e materialeve te ofruara. Ky fakt ka nje rendesi paresore sepse deshmon sa me poshte:

2.3.4. Deklarate mbi origjinen e mallit (ku te percaktohen vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese).

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me **piken 1 te nenit 36 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”**, ne te cilën eshte e percaktuar se: *1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen nënenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një process specifik për një fazë tjetër të cikli tjetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë*

të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. Gjithashtu ky kriter është në përputhje me pikën 2 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entitet kontraktor e parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, nëpërputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Në këtë kontekst është kërkuar dhe deklarata e origjinës dhe prodhuesit, me anë të së cilës do të bëhet e mundur verifikimi me i saktë i artikujve të ofertuar, specifikimeve të tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi.

2.3.5. Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara. Në katalogë, duhet të markohen me ngjyrë të ndezur, specifikimet teknike sipas DST. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin **e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë në gjuhën shqip ose anglisht**).

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, si dhe me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: [...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së paisjeve mjekësore që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST në Shtojcën përkatëse

Sa me sipër, anëtarët e njësisë së prokurimit duke u nisur edhe nga specializimet që kanë, shqyrtuan dhe miratuan kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit kualifikimit në mbështetje të ligjit nr. nr.162 dt.23.11.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, VKM nr. Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i përditesuar) Kreu IX, Neni 74

Puna për përcaktimin e Kritereve të Veçanta të Kualifikimit është organizuar ne mbështetje dhe sipas parashikime ligjike ne VKM nr. Nr.285 datë 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, (i perditesuar) Kreu IX, Neni 74 ku specifikohen qartazi detyrat e secilit prej anetareve te njesise se prokurimit

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Në seksionin e specifikimeve teknike, *komisioni* vendosi te njëjtat specifikime teknike dhe sasi e kërkesa të përcaktuara nga hartuesit e specifikimeve teknike(mjeket okuliste) dhe sipas relacionit te perlllogaritjes se fondit limit paraqitur nga sektori I planifikimit në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallit në DST të kësaj procedure prokurimi.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

N r	Emertimi me specifikime teknike	Njesia
1	Tripan blu me te pakten 0.06% -1ml	flakon
2	Viskoelastik Dispersiv; Hydroxy propyl methyl celulose solucion 2%,-2 ml. Pesha molekulare: 80,000-86,000 daltons; pH: 6.0-7.8. Osmolaliti: 250-350 mosmol/Kg;	cope
3	Viskoelastik Koheziv; 1-1.6% Sodium Hyaluronate me paketim 0.8-1ml; Pesha molekulare: 1.000.000 - 3.000.000 daltons pH: 6.8-7.6; Osmolaliti: 260-360 mosmol/Kg;	cope
4	Thika korneale, sklerale per tynel anesor ne forme V, 20 G	cope
5	Thika Korneale, per tynel anesor me tehun preres 15 0	cope
6	Thika Korneale per te realizuar tynelin kryesor, e harkuar me kend, 2,75mm	cope
7	Thika Korneale Kreshente me kend dhe me teh te dyfishte	cope
8	Retraktor Irisi qe realizon dilatim mekanik te pupiles.	cope
9	Lente intraokulare e bute asferike, asimetrike, bikonvekse hidrofobike/hidrofilike se bashku me kartrixh per injektim, me diameter Optik 6-6.5 mm; Gjatesia maksimale 12.5 — 13.5 mm; I gjithediapazoni I Dioptrive te perfshije nga -7D deri ne + 40D	cope
10	Lente intraokulare e perthyeshme asferike, 3 pjese hidrofobike/hidrofilike bikonvekse se bashku me injektorin njeperdorim per injektim, Diametri Optik 5.5-6mm; Gjatesia maksimale 12.5-13.5 mm;I gjithe diapazoni I Dioptrive te perfshije nga -7D deri ne + 40D	cope
11	Unaze Kapsulare e hapur me material PMMA me kend 270 grad, Injektori qe perdoret eshte njeperdorimeshe	cope
12	Soluçjon BSS 500ml me pH 7,2-7,6 dhe me osmolalitet 298-305.	cope

13	Kasete njeperdorimshe per fakoemulsifikim, per prerje 2.85-3.0 mm kompatibel me fako Stellaris ose ekuivalent	cope
14	Set vitrektomie anteriore kompatibel bimanual me fako Stellaris ose ekuivalent	cope
15	Maja metalike e drejte 2.85-3.00 mm kompatibel me fako Stellaris ose ekuivalent	cope
16	Sliva kompatibel me aparatn kompatibel me fako Stellaris ose ekuivalent	cope
17	Lente intraokulare e forte posteriore hidrofilike/Hidrofobike ; Diametri Optik 5.5-6 mm;Gjatesia maksimale 12.5-13.5mm	cope
18	Lente intraokulare e forte Anteriore me fiksime ne iris hidrofilike/hidrofobike; Diametri Optik 5-6 mm;Gjatesia maksimale 8.0-13.5 mm; I gjithe diapazoni I dioptrive te perfshije nga +2D deri ne +30D	cope
19	Ophthalmic surgical drape sterile	cope

Numri i dioptrise se lenteve do të kërkohet nga Shërbimi I ORL OKulistikes në ekzekutimin e kontratës, gjithashtu numrat që nuk do të lëvrohen do të ndërrohen nga operatori ekonomik fitues sipas nevojave të shërbimit.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Afati i skadencës: data e skadencës në ditën e lëvrimin të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës. Skadenca duhet të jetë e shënuar në ambalazh. Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DST të kësaj procedure prokurimi.

Argumentim: Në bazë të nenit të 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion kërkesat e cilesise për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Njesia e Prokurimit: